

LIGJ
Nr. 33/2014

PËR MIRATIMIN E HUAMARRJES PREJ
295 420 000 SDR-SH, QË FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR I AKORDON SHQIPËRISË PËR
PROGRAMIN 36-MUJOR TË NDIHMËS (EFF)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, 84, pika 4, dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet huamarrja prej 295 420 000 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF) me termat, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 3.4.2014

ANEKSI 1

Termat e huas paraqiten si më poshtë:

Shuma e huas 295 420 000 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) SDR.

Norma e interesit është e lidhur me normën e interesit për SDR, që aktualisht është 1,13 %. Ky interes do të paguhet për shumën e kredisë së tërhequr dhe të pashlyer deri në masën 180 000 000 SDR (që përbën 300 % të kuotës së anëtarësisë).

Për pjesën e huas të tërhequr dhe të pashlyer mbi shumën e mësipërme, aplikohet një interes i barabartë me normën bazë + 200 bp. Në rastet kur shuma e kredisë së tërhequr dhe të pashlyer kalon vlerën 180 000 000 SDR për një periudhë mbi tre vjet, norma shtesë që aplikohet mbi normën bazë të referencës rritet në 300 bp.

Komisioni i angazhimit aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore nga data e miratimit të huas në Bordin e FMN-së, mbi shumat që parashikohet të tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0,15 %) për shumat të angazhuara që nuk e kalojnë vlerën prej 120 000 000 SDR-sh (që përbën 200 % të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN), ndërsa për shumat të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë, norma e komisionit rritet në 30 bp (0,3 %).

Ky komision i rimburohet vendit në rast se tërhiqet e gjithë shuma e huas së angazhuar brenda afatit të parashikuar.

Komisioni i shërbimit aplikohet mbi çdo shumë që tërhiqet nga huaja dhe është në masën 50 bp (0,5 %).

Maturimi i huas është 13 vjet dhe përfshin një grace-periode prej 4 vjetësh.